Lezhë, më 31.10.2023

# PROCESVERBAL

- I mbajtur sot, në dt. 31.10.2023, në orën 12:00, në sallën e bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Lezhë, për muajin Tetor 2023.
- Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe dy projekt-vendime shtesë për shqyrtim.
- Ndue Luli: kush është dakord me rendin e ditës?
- kërkoi fjalën për procedurë këshilltarja Alfrida Marku.
- Alfrida Marku: Përshëndetje të gjithëve.

Siç kam vënë në dijeni Kryesinë e këshillit nëpërmjet emailit zyrtar, për dijeni Kryetarit të Bashkisë dhe Prefektit, kjo mbledhje ka probleme procedurale, të tilla, që bëjnë të pavlefshme çdo vendimmarrje që derivon prej saj.

Së pari, siç e dimë të gjithë, këshilli i Bashkisë nuk ka zhvilluar asnjë dëgjesë publike apo konsultim për të paraprirë hartimin apo propozimin e Paketës Fiskale.

Së dyti, sipas nenit 22, pika 4 e rregullores mbi funksionimin e këshillit, kryesia përcakton rendin e punëve të mbledhjes së ardhshme të këshillit në një mbledhje që zhvillohet të paktën 10 ditë pune para datës së mbledhjes së këshillit. Kryesia vendos me shumicën e votave për rendin e punëve të mbledhjes. Kjo në fakt nuk ka ndodhur.

Sipas nenit 64, pika 2, po të rregullores, numri

i projektakteve të përfshira në rendin e ditës në mbledhjet ku diskutohet Paketa Fiskale nuk mund të jetë më shumë se dyzet. Siç e shikoni dhe në ftesën e njoftuar, ne kemi 17 çështje për diskutim sot. Unë u bëj thirrje gjithë këshilltarëve që të respektojmë ligjin dhe rregulloret si kushte bazë për një qeverisje të mirë. Të marrim të gjitha masat që çdo mbledhje këshilli të jetë në respektim të procedurës dhe kësisoj unë e konsideroj të parregullt rendin e ditës që keni njoftuar për sot.

- Ndue Luli: Mendimi jot.

Vazhdojmë.

- kërkoi fjalën për procedurë këshilltari Lirim Torba.
- Lirim Torba: Përshëndetje të gjithëve
Desha të bëj vetëm një pyetje. A është mbajtur mbledhja e kryesisë dhe n.p.s po në çfarë date është zhvilluar? Meqë nuk kemi disa çështje për sa i përket Paketës Fiskale, ne mendojmë që pikat 8, 11, 12, 13 në rendin e ditës të shtyhen për një mbledhje tjetër.
- Kërkoi fjalën për procedurë këshilltarja Flutura Gjoni.
- Flutura Gjoni: U shtuan dy projektakte këtu. Në bazë të nenit 34/8 nuk mund të shtohet asnjë projektakt pa kaluar më parë në komision. Unë jam pjesë e komisionit të Mandateve i cili nuk është mbledhur dhe Komisioni i Financës nuk

ka funksionuar.

- Ndue Luli: Ne jemi organ kolegjial prej 41 këshilltarësh për çdo gjë që mund të vijë nga komisionet përkatëse të këshillit është e drejtë të shqyrtohet dhe merret vendimi përkatës nga 41 këshilltarët. Ne mund t'i miratojmë ose siç i sjellin ato, por ne kemi të drejtën legjitime që t'i hedhim poshtë ato. Kështu që për arsye objektive mund të ndodhë mosrealizimi i mbledhjeve të komisioneve, por kjo nuk do të thotë që ky projekt vendim të mos propozohet në mbledhjen e këshillit. Disa këshilltarë kanë qenë sëmurë dhe kanë njoftuar. Jemi ne ata që vendosim a ta miratojmë për ta diskutuar apo jo. Kështu që unë u bëj thirrje këshilltarëve kush është dakord me rendin e ditës le të ngrejë kartonin PRO.

20 vota janë PRO. KUNDRA janë 7 vota dhe konkretisht këshilltarët Alfride Marku, Rrok Marku, Flutura Gjoni, Donika Hakhia, Donika Ndoj, Sovetjan Kasova, Emanuel Përgjoku dhe 1 votë abstenim nga këshilltari Lirim Torba. Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e parë që është projekt vendim "Për dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Emisjon Alfred Mali".

Kush është dakord që Emisjoni të marrë mandatin? Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë. Kuptohet që kjo është në bazë të shkresës që ka

ardhur nga KQZ.
Po lexoj formulën e betimit (Ligji 139/2015, neni 50)
- Emirjon Mali: Betohem
- Ndue Luli: Nënshkruaj dhe formulën e betimit dhe dorëzoje sekretarisë. Suksese.
Pika e dytë do jetë "Informacion mbi furnizimin me energji elektrike të Bashkisë Lezhë dhe problematikat që kërkojnë zgjidhje nga z. Gentian Fiçorri, koordinator i OSHEE Lezhë".
Fjala për ju.
- Gentian Fiçorri: Përshëndetje të gjithëve.
Unë si koordinator i OSHEE Lezhë deri tani jam njohur me të gjitha problematikat që ka kjo zone. Kam rreth një muaj që kam ardhur. Stafin tim teknik inxhinierik e kam në gadishmëri të plotë, duke e ditur që është një zonë me shumë probleme. Unë bisedova dhe me kryetarin e Bashkisë, për çdo problem do i dalim para dhe do i japim zgjidhje. Do bëjmë të pamundurën për çdo ankesë. Kemi marrë masa për të përballuar situatën për të gjithë hidrovoret, për mbarëvajtjen e punës. Të gjithë pyetësorët do marrin zgjidhje në kohë shumë të shpejtë. Kaq kisha.
- Ndue Luli: Duke qenë se parasysh se kemi vendime shumë të rëndësishme, do kemi maksimumi 20 minuta për të diskutuar në lidhje me informacionin.
Zj. Ndoj.
- Donika Ndoj: Në fakt është absurde që diskutojmë

sot për problemin e furnizimit me energji elektrike, në shekullin XXI, sidomos për një qytet bregdetar që është qyteti i Lezhës me një relievë të ulët dhe të favorshëm. Unë në fakt z. Gentian të uroj shumë suksese por ne kemi probleme të shumta të furnizimit me energji elektrike. Nga ana tjetër ne krenohemi që kemi krijuar dhe të ardhura me turizmin në Shëngjin apo në Tale, ndërkohë që ka ndodhur shpesh herë që jemi përballur me mungesën e energjisë elektrike. Imagjino një qytet bregdetar si Shëngjini apo dhe zona të tjera si Talja. Njëkohësisht unë jam banore e Mj. A. Zejmen. Që ta kesh të qartë, Zejmeni është i persekutuar për vite me radhë në furnizimin me energji elektrike. Ne ngrysemi pa drita dhe gdhihemi pa drita. Pothuajse 2-3 herë në javë ndodh i njëjti fenomen dhe me orë të zgjatura. Bizneset paguajnë. Ndaj qytetarët kërkojnë llogaridhënie. Nga ana tjetër unë jam mësuese. Nuk kemi regjistër fizik dhe duhet të njoftojmë prindin online direkt nëse fëmija i tij është në mësim apo çfarë përgatitje ka sot, kur jemi në kohën e digjitalizimit. Unë paguaj 3000 euro energji në biznesin tim. Çfarë do ndodhë? Unë paguaj taksën vendore ndërkohë që online kërkohet që të priten dhe ato TVSH-të. Ju kërkoni dhe nuk na ofroni. Prandaj kërkoj që ju të na jepni shërbimin dhe ne paguajmë sepse jemi korrektë. Të jetojmë si qytetarë në këtë vend. Shpresoj që ju z. Gentian

të vendosni një emër të mirë dhe të jeni i aftë, jo vetëm për Zejmenin. Jemi totalisht të falimentuar në organizimin e jetës sonë pyetetare, familjare. Faleminderit.

- Gentian Fiçorri: Faleminderit edhe ty për urimin. E nisim nga Shëngjini meqë e përmendët. Shumë shpejt do fillojë investimi dhe komplet zona e Shëngjinit do kalojë në nivelin 20 KV. Gjithashtu edhe për Talen e njëjta situatë është. Më thatë për problemet në zonën e Zejmenit. Që kur kam ardhur, në të gjithë fiderat që furnizojnë me energji elektrike Zejmenin, Krytën, Shënkollin dhe gjithë këto zonat, kam filluar një plan remonti. Ne po punojmë krahas dhe kurstëve e burimeve njerëzore që kemi dhe nuk do shkëputet energjia elektrike siç ka qenë shkëputur. Do ketë remonte, do ketë investime dhe nuk do ndodhë më ky fenomen. Do ketë shkëputje të pjesshme por jo shkëputje me orë të tëra siç ka qenë situata.

- Ndue Luli: Fjala për znj. Hoxhia.

- Donika Hoxhia: Përshëndetje. Në fakt këtu te rendi i ditës e kishim informacion dhe realisht unë prisja informacion. Informacioni nga ju mungoi, gjithsesi ne si pyetetarë kemi informacionet tona. I bashkohem kolegës për lagjen e hotelit. A ke ndërruar i gjithë stafi drejtues apo problemi paska qenë i koordinatorit për jo mbrojtjen e energjisë. Këtë nuk po e kuptoj. Gjithsesi e mirëpres dëshirën tuaj për të zgjidhur çdo problem. Do bëjë një pyetje shumë të thjeshtë. A do

u blihen pyetësorëve elektroshtëpiaket kur t'u digjen? Këtu kam një relacion nga bashkia për ndryshim në miratimin e buxhetit. Thuhet: "Duke qenë se pompat po dëmtohen për shkak të luhatjeve të energjisë elektrike ...". Pra, shikohet si problem luhatja e energjisë elektrike. Pra është një problem i imi familjar por edhe i shumë zonave.

- Alfrida Marku: Suksese zotërisë. Në fakt, jo vetëm Zejmeni, por të gjitha zonat kanë probleme themelore me furnizimin me energji elektrike, për shkak të gjendjes tepër të amortizuar të rrjetit të shpërndarjes. Pavarësisht se ministrat e energjitikës, apo ish deputetë të periudhës 2018-2021 kanë propaganduar investimin 5 mld në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për Lezhën, ju thotë që do ndërhyni në përmirësimin e gjendjes në Lezhë, ama në një dokument zyrtar që unë disponoj nuk është shënuar asnjë lek për Lezhën. Më lejoni t'ju drejtoj disa pyetje konkrete. 1- Sa km linjë përcjellëse në sistemin shpërndarës në tensionin 0,4 kV janë zëvendësuar me përcjellëse të reja? 2- Sa km në zonat rurale janë zëvendësuar me kabull ABC në 0,4 kV? 3- Sa transformatorë 10/0,4 dhe 6/0,4 kV ka në Bashkinë Lezhë? 4- Sa investime konkrete janë bërë në shtylla transformatorë, sisteme mbrojtjeje dhe përcjellës Alumin + Çelik dhe kabull ABC në TU në Lezhë, Shëngjin dhe në fshatra? 5- Sa punonjës ka OSHEE dhe a punojnë me turne? A u paguhen orët shtesë? A

kanë transport në dispozicion?
Unë mund t'jua vë në dispozicion dhe me shkrim.
Për sa kohë që ju sot na kishit njoftuar që do relatonit për situatën në Lezhë dhe kjo nuk ndodhi, unë ju ftoj dhe ju kërkoj, dhe pse jo në mbledhjen e radhës të vini më i përgatitur dhe më i saktë dhe i plotë mbi atë se çfarë masash do merrni realisht.

- Ndue Luli: Faleminderit. Pyetje tjetër?
- Lirim Torba: Vetëm diçka kisha unë. A është parashikuar gjë në lidhje me rregjitjen e sigurisë së transformatorëve në qytetin e Lezhës?
- Gention Fiçorri: Në lidhje dhe me atë që tha dhe parafolësja, pasi të njihem me gjithë problematikat që ka zona e Lezhës, mund t'ju jap një informacion të saktë mbi çdo situatë. Në lidhje me transformatorët, janë marrë masat e sigurisë. Faleminderit.
- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Marku.
- Agostin Marku: Është një gjë shumë pozitive që Këshilli i Bashkisë fillon më në fund me këto interpelancat me institucionet që ushtrojnë aktivitetin në Bashkinë e Lezhës, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Ne do të vazhdojmë dhe në të ardhmen sepse kemi miratuar një plan tematik për këtë. Sa i përket problematikave në fushën e energjisë, unë mendoj se dhe nga propaganda por dhe nga publikimet e ≠ të institucioneve shtetërore ka investime, janë

harxhuar fonde të konsiderueshme, por s'ka efektivitet të investimeve. Kemi Zejmenin, si njësi, që është më problematiku, por jo pa probleme është Zadrima apo dhe vetë qyteti në zona të veçanta, nga abuzimet, të themi troç, që janë në fushën e energjisë në Bashkinë Lezhë. Ju si koordinator jeni i ri në Lezhë, në këtë punë, mund edhe të mos ta keni njohur gjithë problematikën, unë ju falenderoj për sipërmarrjen, edhe këtu në Këshillin e Bashkisë, që keni dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në këtë fushë si sektor jetik për qytetarët, për industrinë, për gjithë komunitetin lezhjan. Problemi qëndron te personeli që keni në institucionin tuaj. Është teknologjia e duhur për të rritur efektivitetin e punës në sektorin e energjisë.
Faleminderit.

- Ndue Luli: Mendim tjetër? Po z. Troshaj.
- Alfons Troshaj: Sa elektriçistë ke në Zejmen? Sa disponibilitet keni ju për rikthimin e dritave për një defekt që mund të ndodhë në një zonë?
- Gentian Fiçorri: Problemin e Zejmenit që nuk është investuar, unë nuk e di. Unë kam ardhur i painformuar për këtë, për të drejtuar njësinë e Lezhës. Nuk mund t'ju jap asnjë informacion pa u njohur me situatën në terren, mbasi të njihem do ju kthej përgjigje me shkresë. Që kur kam ardhur edhe vetë kam dalë edhe natën në avari, zona me erë dhe me probleme atmosferike që ju e dini. Faleminderit.

- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Marku
- Rrok Marku: Z. drejtor, sukses në punë. Mjaftojnë kolmm shi që fideri i Kallmetit të bjerë. Ju lutem merrni masa se po vjen dimri, pastaj 99 % të punëve janë të lidhura me energjinë elektrike
- Ndue Luli: Meqë nuk ka mendim tjetër unë do thojë, duke parë parasysh si është gjendja e furnizimit me energji elektrike në Lezhë, çështje kryesore është rrjeti përcjellës, për të cilin duhet vënë dorë sa më shpejt. Z. Gentian jeni i lirë.
Kalojmë te projekti vendimi tjetër shtesë "Për miratimin e liberalizimit të tarifave të ujit të pijshëm, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura".
- Agostin Marku: Unë gjykoj ka ardhur nga Kryetari i Bashkisë. Mendimi im personal është që nuk kemi asnjë arsye për ta zgjatur. Ne si këshill do të mbrojmë konsumatorin, do të mbrojmë popullatën e kësaj zone, edhe subjektet private dhe s'duhet të lejojmë që Enti Rregullator ta rrisë çmimin e ujit të pijshëm dhe shërbimeve të tjera të cilat nuk janë të arsyeshme për territorin e Bashkisë Lezhë. Nuk kemi nevojë ta kalojmë as në Komisione, as në mbledhje të tjera, që t'i japim mundësi Entit Rregullator që të abuzojë, që këshilli i Bashkisë nuk është i gatshëm, pastaj ne po vendosim. Sepse nuk është hera e parë që është abuzuar me Bashkinë e Lezhës për këtë punë, pastaj janë çmimet e ujit kaq

se jonë, jo se nuk ka shërbim, por kjo nuk e justifikon rritjen e çmimit. Nuk e di ça mendimi ka vetë bashkia. Unë propozoj që ne t'ia kthejmë dhe t'i themi me vendim të prerë që nuk lejon këshilli i Bashkisë rritjen e tarifave të ujit të pijshëm dhe të shërbimeve të tjera.

- Lindi diskutim nga këshilltarët e opozitës në lidhje me mosnjohjen e projekt vendimit.
- Kryetari z. Ndue Luli hodhi në votim p/vendimin. Këshilltarët votuan KUNDRA, përveç këshilltarëve Alfrida Marku, Pjetër Tushaj, Flutura Gjoni, Emanuel Përjaku, Donika Hoxhia, Donika Ndoj, Sorelfjan Kosova që nuk votuan, por pas sqarimit të bërë nga ana e kryetarit të Bashkisë z. Pjerin Ndreu, të gjithë këshilltarët u shprehën kundra projekt vendimit. Sqarimi i z. Ndreu si në vijim:
- Pjerin Ndreu: A e votuat kundra? S'jam dakord me liberalizimin e çmimit. Ne jemi të detyruar ta sjellim në këshill. Unë personalisht nuk jam dakord me liberalizimin. Mepë e kam sjellë unë po ju them që detyrimi im ka qenë i drejtpërdrejtë për këtë gjë. Për Shqipërinë të gjithë së ujësjellësit më rentabël në Shqipëri, nuk mund të mbushë arkën as të Kurbinit dhe as të Mirditës. Formalisht ne jemi të detyruar ta sjellim në këshill. Jemi kundra, nuk e lejojmë me vendim këshilli bashkiak.
- Ndue Luli: Vazhdojmë më tej me projekt vendimin "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën

ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2023".
Miratohet me votat PRO të të gjithë këshilltarëve të pranishëm.
Vazhdojmë me projekt vendimin "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit F.Gj.T., F.P.M dhe I.R.K. nga fondi i emergjencës".
Emrat janë me inicale për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave. Këshilltarët i kanë të dhënat për të tre rastet.
Miratohet me votat PRO të të gjithë këshilltarëve prezent.
Kalojmë te projekt vendimi "Për miratimin e përmbajtjes dhe modeleve të akteve për kundërvajtjet në pyje".
Fjalën e ka Komisioni i Bujqësisë. z. Dod.
- Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Komisioni i Bujqësisë u mblodh dje dhe shqyrtoi p/vendimin për disa formularë që i shërbejnë Sektorit Pyjor në bashki. Ftoj këshilltarët që te votojnë.
- Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.
Miratohet me votat PRO të të gjithë këshilltarëve prezentë.
Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që është projekt vendim "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim me kontratë pirogje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet".
Fjalën e ka përsëri Komisioni i Bujqësisë.
- Dod Jaku: Edhe këtë projekt vendim komisioni i

Bujqësisë e ka diskutuar dje dhe është dakord që kjo sipërfaqe pyjore të jepet me qera për një periudhë 10 vjet. Është mbështetur në dokumentacion teknik nga specialistët e kësaj fushe. Nuk cënohen zonat e gjelbra. Është një zonë inproduktive. I urojmë sukses kujtdo që do e marrë atë pjesë dhe shpresojmë të ndihmojë në problemet e energjisë. Pati një problem teknik. Në relacion është i përcaktuar koeficienti i mjësisë matise ndërsa në p/vendim jo. Me këtë ndryshim, komisioni ka qenë dakord që të kalojë.

- Agostin Marku: Me kryetarin e komisionit e kam më tepër. Në projekt vendim nuk mund të futet emri se i bie që nuk ka garë. Te relacioni është shkruar emri në kuadrin e transparencës. Se kush hyn në garë nuk është puna jonë. E dyta, ne thamë dje që vlera të shkruhet për njësi, mepë do këtë procedura prokurimi, sepse gjatë rrugës mund të ndodhin probleme të tjera, merr një metër më tepër, merr 2 metra më pak, dhe gjithmonë i referohemi njësisë me vlerën përkatëse.
- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Tushaj.
- Gjetër Tushaj: Në lidhje me këtë. Të gjitha bashkitë e komunat kanë dhënë toka me qera. Duhet të merren të gjitha masat që mos të kemë probleme.
- Ndue Luli: Një sqarim të shkurtër. Në lidhje me këtë projekt vendim është zhvilluar një konsultim publik me banorët e zonës atje.

Mepë nuk ka më diskutime e hedhim në votim me

propozimin e bërë.
Miratohet me 27 vota PRO dhe 2 ABSTENIM nga këshilltarët Alfride Marku dhe Donika Haxhia.
Vazhdojmë me rendin e ditës me projekt vendimin "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 120, datë 02.12.2022 "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023"".
Fjalën e ka komisioni i Financës.
- Agostin Marku: komisioni është dakord të kalojë dhe të miratohet nga këshilli pasi ka të bëjë me sistemimin e disa fondeve të cilat diku dalin më shumë se sa duhet, në kuptimin për ka kohen kohe dhe të prokurimeve dhe të çështjeve të tjera dhe duhet të mbyllin ca detyrime të tjera për këtë të bëjnë më shumë me energjinë elektrike
- Ndre Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera e kalojmë në votim.
Miratohet me 27 vota PRO dhe 2 ABSTENIM nga këshilltarët Alfride Marku dhe Donika Haxhia.
Kalojmë te projekt vendimi tjetër "Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për 4 mujorin e dytë të vitit 2023".
Fjalën e ka komisioni i Financës.
- Agostin Marku: Edhe për këtë p/vendim komisioni është dakord. Është një çështje ligjore për kërkohet të miratohet në këshillin e Bashkisë. ka të bëjë me buxhetin faktik për 4 mujorin e dytë.

- Ndue Luli: Në lidhje me këtë p/vendim kush ka mendim? Meqë nuk ka, e kalojmë në votim.
Miratohet me 25 vota PRO, tre vota kundër nga këshilltarët Alfrida Marku, Sardjan Kosova, Emanuel Përgjoku dhe një abstenim nga këshilltarja Donika Ndoj.
Vazhdojmë me rendin e ditës, me projekt vendimin "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësiret fiskale, strukturat e njësisë së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve".
Po z. Kryetar.
- Pjerin Ndreu: Po e fillojmë me diskutim në parim, pa hyrë në detaje. Si specialist i fushës do flasë drejtori i Taksave. E para, ne nuk kemi Paketë Fiskale të re, është ajo që është miratuar në vitin 2019. Mund të ketë rregullime të vogla, edhe sipas vërejtjeve që kanë bërë grupe të ndryshme të interesit, sidomos të reflektuara në takimin me biznesin në Shëngjin. Ku është bërë një diskutim i hapur për disa detaje që në fakt edhe i shpetisojnë. Ka një përpjekje të sforcuar për të nxjerrë sikur ne kemi ardhur me rritje taksash. Unë u kërkoj këshilltarëve më shumë përgjegjshmëri dhe saktësi në interpretime. Ça prisni ju, që t'i lëmë njësoj atë që e ka 100 m² me atë që e ka 1000 m²? Ka biznese që për arsye të ndryshme politike apo personale nuk janë dakord. Ky nuk është problemi fare. Në asnjëren

lloj taksе ne nuk jemi ngjit sipër. Nuk ne shkon asnjërit që të gënjejmë. Ja lë drejtorit të Taksave ta interpretojë taksë për taksë. Pastaj diskutojmë nëse ka ndonjë propozim për të ndryshuar ndonjë gjë.
Modelet e konsultimit publik këtu kanë qenë të ecute dhe nga modeli zero në modelet tona ka diferencë shumë të madhe, megjithatë nuk është se mund t'i sjellim të gjithë banorët e Lezhës, pavarësisht se nëpërmjet rrjeteve sociale dhe strukturave, ne jemi munduar t'i thërrasim. E dyta, këtu në këshill përfaqësoni të gjitha votat, ndarjet politike dhe kjo nuk do të thotë që duhet të kalojmë masën, siç ka ndodhur në konsultimet për pyetjen.
Kemi kaluar turbulenca me tërmet, pandemi, krizë ekonomike. Shpërndarimet që janë bërë më parë, kur të doni jua bëjmë publike, që të kuptoni dhe një gjë, të flasim me shifra të parta.
- Ndue Luli: Drejtori i Taksave e ka fjalën.
- Dritan Boçi: Materialin që ju kemi dërguar, dokumentin fiskal për vitin 2024, kemi pasur grup pune me drejtorin e Urbanistikës, drejtorin e Shërbimeve Publike, me administratorët e njësive, kemi bërë dëgjesat publike në fanijore në të gjitha zonat duke ju prezantuar vlerën e çmimit mbi të cilën bazohen përllogaritjet e faturave, duke krahasuar vlerën që u ka vendosur bashkia ndër vite. Qëllimi për të rregulluar paketën ekzistuese që është një paketë shumë e mirë

është në lidhje me implementimin e sistemit të ri të taksave në Bashkinë e Lezhës. Viti 2024 do garantojë një faturim automatik për bizneset nga vlerësimi manual. Në kategorinë "Familjarë" synojmë që viti 2025 të jetë në të njëjtën mënyrë, e kalkuluar në mënyrë automatike, duke pasur parasysh dhe draft ligjit kombëtare mbi taksën e pasurisë që do hyjë në fuqi në vitin 2026 si dhe me draft ligjin për Turizmin që do ndikojë drejtpërdrejt në taksën e fjetjes, kjo në bazë të numrit të bizneseve që kemi në databazë dhe të shpërndara dhe sipas llojit të aktivitetit. dhe familjarët nga Ujësjellësi dhe njësitë vendore. Kemi marrë për bazë dhe reflektimin e të ardhurave ndër vite të cilat janë në rritje pasi në vitin 2020 si vit i pandemisë me 2023 ku jemi. Ndryshimet e para që propozojmë kanë të bëjnë me taksën e pasurisë. Në videoprojektor keni dhe si reflektohej në vlera ndër vite, me vitin 2019 siç është futur paketa fiskale, me ndërhyrjen jo të zakonshme por të domos-doshme për të ulur nivelin e taksave në Bashkinë e Lezhës dhe në reflektimin në pas në vitin 2021 për t'iu përmbajtur legjislacionit në fuqi. Në draftin që prezantojmë sot kemi taksën e pasurisë për të cilën synojmë të mbledhim të dhëna pasi kemi akoma biznese që nuk deklarojnë se sa $m^2$ pronësi kanë në dispozicion, kanë dhe biznese që deklarojnë vlerë të ndryshme nga realja. dhe kemi propozuar që të

mbledhim nëpërmjet vetëdeklarimeve deri në 31 janar 2024 dhe për familjarët deri 30 prershor 2024. Është reflektuar taksa e truallit sipas VKM-ve pra nuk kemi rritje, por vendosje në skina ligjore. Taksa mbi tokën bujqësore vazhdon të jetë në nivele minimale siç e përcakton ligji. Po të shohim një shembull hipotetik të taksës së pasurisë për një ndërtesë 100 $m^2$ me truall 100 $m^2$, taksa e ndërtesës është pjatur 3000 lekë, u bë në 2019 2400 lekë dhe 2021 është bërë 3000 lekë sipas reflektimit. Tarifat e shërbimeve për familjarët janë ulur. (i referohet slide-ve bashkëngjitur)

- Pjerin Ndreu: Ajo ishte i përket kohës së asaj Zonjës, pra siç e shikoni ne nuk kemi ngritur asgjë. Ose jemi në nivel, ose jemi poshtë, dhe kemë qenë në nivelin maksimal.
- Dritan Boçi: Dhe në total kemi ulje për kategorinë "Familjarë" me 14% për zonën A, me 24% për zonën B dhe 31% për zonën C.
 Se i përket biznesit, taksa e pasurisë ngelet në të njëjtin nivel, pra vazhdon të jetë në nivelet minimale që lejon ligji. Ajo tjetër që propozojmë për modifikim janë shtimi i ndarjeve të kategorive të tarifave të shërbimeve, për të reflektuar dinamikën e aktiviteteve që ndodhin në Bashkinë e Lezhës, dhe rikategorizim të tyre më të mirë. Në raste specifike siç janë profesionet e lira është reflektuar ndarja sipas xhiros

Dhe jam në dispozicion për çdo pyetje që mund të keni.

- Ndue Luli: Fjalën e ke z. Marku

- Agostin Marku: Së pari dua të them se sa i takon Paketës Fiskale për këtë vit dua të falenderoj Bashkinë, që në bashkëpunim dhe me Kryesinë e Këshillit bënë konsultimet publike me qytetarët, me grupet e interesit, gjë e cila në një masë të mirë të problematikës është reflektuar në Paketën Fiskale dhe që ka të bëjë me ndërgjegjësimin e komunitetit dhe grupeve të interesit për të rritur efektivitetin e saj, e për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të investimeve publike në Bashkinë e Lezhës. Unë mendoj që në tërësi, në Bashkinë e Lezhës nuk është problem niveli i taksave dhe tarifave sepse kemi qenë brenda kuadrit ligjor dhe që kemi kompetencë ne si këshill. Një bashki që bën politika për t'i ulur, i bën për një qëllim të caktuar, për të mbushur arkën. Por unë mendoj se problemi kryesor në Bashkinë e Lezhës është tjetër, çështja e menaxhimit të sistemit dhe ndërgjegjësimi i grupeve të interesit për këtë çështje për të realizuar mbledhjen e taksave sipas kapacitetit fiskal që ka Bashkia e Lezhës.

Unë si kryetar komisioni kam synuar që dje të mbledh komisionin e financës, nuk është bërë e mundur për arsye të mospjesëmarrjes, pra mungesë kuorumi për vendimmarrje të komisionit. Në bazë të rregullores e

kam shtyrë 24 orë. Dikush nga anëtarët ka pasë një problem, dikush jashtë shtetit, dikush edhe për arsye të mandatëve të lëvizjes së forcave politike është krijuar vakuumi. Duhen marrë masa për të gjitha komisionet, në mënyrë që të shterrojë shqyrtimi i këtyre problematikave, në mënyrë që mos ta ngatërrojmë këshillin me gjëra profesionale, jo çdo këshilltar është specialist i të gjitha fushave apo universal, për t'i plotësojmë këto vakanca, që të bëjmë të mundur funksionimin normal të komisioneve dhe të bien propozime të ndryshme në këshill, që gjithsesi, merr apo s'merr vendim komisioni, në fund të fundit vendimmarrja i përket këshillit.

Gjithsesi, me aq sa ishim të pranishëm sot, si anëtarë komisioni, me Drejtorinë e Taksave por dhe me gjithë drejtoritë e tjera, ne diskutuam disa probleme të cilat mendnam se duhet t'ia bëjmë të parët këshillit të Bashkisë. Komisionit të Financës dhe kryetarit të këshillit i është drejtuar me propozime këshilltarja Alfrida Marku, e cila i përket Partisë Demokratike, të cilat u morën një nga një dhe u diskutuan me drejtorin e Taksave, ne arritëm në konkluzionin që nuk i përkasin realitetit fiskal në Bashkinë Lezhë por që propozime të caktuara bien ndesh edhe me ligjin, edhe me hapësirat ligjore që ka këshilli i Bashkisë për t'i realizuar ose miratuar.

Alfrida Marku: Mund t'i relatoj unë.

- Agostin Marku: Ti vepro si të duash kur të vijë radha. Mua më ke sjellë një shkresë.
- Alfrida Marku: Minimalisht është dashur të më thërrisni në mbledhjen e komisionit.
- Agostin Marku: Në mbledhjen e komisionit ke qenë edhe dje. Kryetarit të grupit PS dhe juve, ju kam thënë që jeni të ftuar në mbledhjet e komisionit të Financës sa herë që të bëhen. Të lutem mos e paragjyko. Ruaj etikën dhe edukatën, mos i ndërhy tjetrit në diskutim, se askush nuk të ndërhyn ty.
- Alfrida Marku: Po e shkel ti etikën.
- Agostin Marku: Unë po të respektoj. E kam filluar diskutimin me propozimet që ju i jeni drejtuar komisionit të Financës. Unë po flas publikisht në mbledhje. Më transparencë ku ke? Me anëtarët e komisionit që ishin prezent dhe me drejtorinë arritëm në konkluzionin që propozimi i parë për përjashtimin nga pagesa e të gjitha taksave e tarifave vendore për bizneset që drejtohen nga të rinjtë e moshës 18-35 vjeç, për periudhën '24-'27. është pa sens sepse po të shikohet ky propozim, kur kemi në paketë fiskale, edhe ata që janë mbi 35 vjeç t'i kalojnë bizneset te familjarët e tyre nën 35 vjeç. Propozimi i dytë - Përjashtimi nga taksat e tarifat vendore të nënave kryefamiljare, nënave vajza dhe nënave që ndjekin studimet e larta - Po, për një pjesë të këtyre kategorive, po të lexohet me vëmendje paketa fiskale, janë në lehtësirat fiskale të propozuara

nga Kryetari i Bashkisë. - Edhe këtu, hajde t'i regjistrojmë gratë kryefamiljare dhe e realizojmë paketën fiskale me dy rreshta. 3- Propozojmë unifikimin e taksës së tabelës për të gjitha bizneset. Niveli i taksës për tabelën e thjeshtë të aplikohet edhe për tabelat me ndriçim dhe elektronike, duke vendosur disa standarte të përshtatshme për anën vizuale. - Nuk ka sens dhe ndikon negativisht sepse po të bëhet unifikimi, ose do e bëjmë bosh komplet tabela sepse e liberalizojmë ose kemi të bëjmë me anarshi sepse nuk kemi të bëjmë fare më me funksionimin e kësaj takse. 4- Krahasuar me Paketën Fiskale në fuqi për vitin 2023, në p/vendimin për vitin 2024 Kryetari i Bashkisë ka propozuar rritjen e taksës së truallit etj etj. - Nuk dua të kaloj në përsëritje sepse e sqaroi drejtori.
5- Sa i përket taksës së fjetjes në hotel, propozojmë uljen në masën 30% edhe për hotelet me 4 e 5 yje, sikurse është propozuar për hotelet me më pak se 4 yje. - Kjo taksë nuk i përket hoteleve, kjo taksë është e individit, ndaj nuk mund të bëjmë që të paguajnë njësoj si një klient VIP, si një klient i zakonshëm. Nuk ngarkohet biznesi me këtë taksë. 6- Propozojmë shfuqizimin e taksës së përkohshme të bizneseve etj për dekorin ... - Nuk është taksë për dekorin, është tarifë, ka dallim të madh. Aty futet edhe: Hotelet me 4 e 5 yje dhe nën 4 yje, në zonën

bregdetare të Shëngjinit e Tales, të paguajnë taksë të përkohshme në masën 15 000 dhe 10 000 lekë në vit për ndërtimin e menaxhimin e qendrave të moshës së tretë. si dhe taksa e dekorit që thamë më lart të zëvendësohet me taksën e përkohshme 2000 lekë për ndërtimin e qendrave sociale për moshën e tretë, pra hiqet një tarifë dhe qytetari ngarkohet me një taksë.

- Alfrida Marku: Mund të jenë edhe për ty.
- Agostin Marku: Edhe për mua edhe për ty se ti je plakur para kohe. Me këtë propozim harrojmë se hotele nuk ka vetëm në Shëngjin e Tale por në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë. N.q.s paguan një hotel në Tale, pse s'duhet të paguajë një hotel në Lezhë? Nuk ka sens në llogjikën ekonomike që të jetë diçka e tillë në Paketën fiskale.

Vazhdojmë më tej - Pika 7 - Se i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë, propozojmë lënien në fuqi të kategorizimit të ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi tregtare, sipas zonave: Shëngjin e Shënkoll, Lezhë, njësitë e tjera administrative sipas parashikimeve të paketës fiskale në fuqi, e miratuar për vitin 2023. Gjithashtu propozojmë zbritjen e kësaj takse në masën 30% krahasuar me parashikimet në P.Fiskale 2023. Për ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit, kjo taksë të jetë e unifikuar në 4% - Në konsultimin që bëmë me drejtorin e Urbanistikës kjo

që kjo është totalisht jashtë ligjit. 9- Në vendimin e propozuar, Kryetari i Bashkisë ka propozuar rritjen e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike nga biznesi, konkretisht 70% për zonën A, 150% për zonën B. Kundërshtojmë këtë propozim si dhe propozojmë lënien e saj në të njëjtin nivel. që parashikohen në paketën fiskale në fuqi në vitin 2023. - Nuk është në përputhje fare me ligjin, në gjykimin edhe të specialistëve që u konsultuam, nuk mund të realizohet. Paketa Fiskale 2023 nuk paska qenë paketë elektorale, por paska qenë paketa më efektive që unë e kam kritikuar në fakt njëherë. 10- Propozojmë zbritjen në 30% të taksës për tokën bujqësore, për sa kohë infrastruktura vaditje-kullim nuk është funksionale në çdo zonë. - E paragjiti drejtori, jemi në vlerat minimale që parashikon ligji.

- Pjerin Ndreu: A mundem të bëj një sqarim të drejtpërdrejtë. në lidhje me taksën për tokën bujqësore i e ka pasë 5600 për zonën e parë 3920 e kemi ne, e ka pasë 4900 3430 e kemi ne e me radhë për të gjitha zonat, kjo po ndodh për bujqësinë. Gjithçka që thotë e ka propagandë.

- Agostin Marku: Dhe propozimi i fundit: sa i përket tarifës për parkimin, propozojmë që me VKB të ndalohet përdorimi si hapësirë parkimi i sheshit "Gjergj Kastrioti" si zonë arkeologjike me rëndësi të veçantë. Në vijim, propozojmë shfrytëzimin për qëllime parkimi të kalit

nëntokë të pallatit në lagjen "Besëlidhja", ndërtuar pas tërmetit të nëntorit 2019, i njohur si pallati i rindërtimit. Kjo hapësirë afërsisht 2000 $m^2$ është e mjaftueshme për të hequr përfundimisht sheshin "Gjergj Kastrioti" nga lista e vendeve të parkimit në qytet.
Është konstatim i drejtë por Lezha ka një problem të madh me parkimin dhe ne e kemi vënë re.
Se herë sheshi është përdorur për aktivitete të tjera, Lezha është bllokuar. Bashkia duhet të gjejë zona të tjera parkimi në mënyrë që të çlirojë jo vetëm sheshin por edhe rrugë të tjera.
Këto janë propozimet tona më lejoni të rendoj si kryetar komisioni.
- Pjerin Ndreu: Më lejoni të bëj një sqarim për taksën e tabelës, 2 - 10 $m^2$ e ka pasë 10.000, është 1000 sot; me ndriçim 15.000 e ka pasë zonja, 3000 e kemi ne.
- Alfride Marku: Unë kam emër, e kam Alfride, nuk mund të drejtohesh ashtu në mbledhje të këshillit të Bashkisë.
- Pjerin Ndreu: Më fal. Elektronike e ka pasë 20.000, 5000 e kemi ne. (lexon tabelën sipas slide-it bashkëngjitur - faqja "Taksa e tabelës"). Që të dini dhe ju këshilltarë se ku jemi me paketën fiskale në raport me këtë që mbajmë flamurin e shpëtimit të familjarëve dhe biznesit. (Gjithashtu lexon dhe tabelën për tarifat e shërbimeve publike për

"Familjarët" – bashkëngjitur). Për vitet 2016–2017
nuk keni fare të dhëna. Do jua nxjerr një për
një se kishtu e mësitom ti, edhe perveto e zyrave
që keni paguar. Në vitin 2018 në fitesë zërat e
tatimeve ke mbledhur 166 mln, në vitin 2019
janë 185 mln, sepse ne kemi ardhur në fund
dhe ke pemë dhe viti ku keni dhënë leje ndërtimi
me okë. Në vitin 2020 ke pemë 191 mln, si
vit i pandemisë kemi shënuar me rënie, kuptohet
se biznesi nuk ka funksionuar. Në 2021 kemi
shënuar 252 mln, në vitin 2022 274 mln. dhe
këtë vit vetëm për 9 muaj jemi 263 mln.
A është ajo që duhet? Nuk është. Prandaj kemi
futur sistemin elektronik

- Agostin Marku: Që të vazhdojmë. Z. drejtor,
Në fq. 2 të planifikimit mendoj mos të jetë pika I.1.
por të futet te zona A në sipër autostrada Lakë-
Milot
- Driton Boçi: Vjen biznesi dhe thotë ndodhem
në Lejmen (Zona B) por realisht ndodhet në
autostradë. Për këtë arsye e kemi çelësuar.
- Agostin Marku: Në fq.3. te pika A.1. Tatimi i
Thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, deri në
cilën vlerë max. është biznesi i vogël. Ke thënë
më i vogël ose i = me 14 mln.
- Driton Boçi: Mbi 14 mln është tatimi që jepet
në Tatime, jo tek ne.

- Agostin Marku: Te fq. 7. keni thënë: Për të përfituar këto lehtësira fiskale kategoria "Familjarë" duhet të dorëzojnë tek strukturat përgjegjëse dhe tek agjenti tatimor i caktuar, që është Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime - mendoj se duhet vetëm në dorën e Drejtorisë së Taksave sepse ajo e përcakton se kush i përfiton lehtësirat, mos t'ia lëmë në dorë agjentit tatimor se atje edhe mund të abuzohet.
- Driten Boçi: Ne monitorojmë agjentit tatimor që është ujësjellësi, i cili të na raportojë çdo muaj dhe çdo vit mbi njerëzit që janë të përjashtuar me ligj.
- Agostin Marku: Në fq. 8. në kategorinë e tokës bujqësore - pika A.2.6.1. ku është përkufizimi, po për tokat që i kanë me tapi apo në përdorim? Unë mendoj që kjo duhet të jetë sipas zonave të caktuara sepse me sa di unë tokat bujqësore janë të ndara në kategori me zona. Po hymë për çdo tapi, ju s'do i dilni kurrë në fund.
- Driten Boçi: Inventarizimit të detajuar do i shërbejë dhe sistemi në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë.
- Agostin Marku: Në fq. 8-9 - në lidhje me kulturat drufrutore - te pika A.2.6.4 të hiqet "për çdo fermer/fermë" - te pika A.2.6.6. Përjashtime nga pagesa e taksës - të shtohet që "Konfirmimi të jepet nga Dr. e Bujqësisë e Bashkisë" - në mënyrë që

të jepet një lehtësi fiskale.
Po te fq. 9. – A.2.c.3 Niveli i Taksës – Keni 2 kategori: për qëllime banimi nga individët dhe për qëllime biznesi. Po për raste të tjera? Nuk e keni parashikuar.

– Dritan Boçi: Është e përcaktuar në ligj, nuk mund të ndërhyjmë ne.

– Agostin Marku: E ke ligji, tërhiqemi.

Te taksa e fjetjes në hotel – për të thënë thatë që jeni përpjekur te ngarkoni me shumë dokumentacione në mënyrë që ta saktësoni – p.sh. vëreni se në krye të 3 mujore x subjekti nuk ka bërë asnjë pagesë atëherë shko verifikoje dhe në bazë të kapacitetit i vendos detyrimin. N.q.s do ta lëmë për fundin e vitit, nuk kemi realizuar gjë. Shikoni çështjen e regjistrit që të bëhet sa më e kontrollueshme sepse dorëzimi dorazi ....

– Dritan Boçi: Ta saktësojmë pak taksën e fjetjes në hotel. – Është mujore, çdo dt. 5 të muajit. Shpresojmë që në regjistrin elektronik që ka projektuar Ministria e Turizmit, të kemi dhe ne aksesin.

– Agostin Marku: Vazhdojmë më tej, në fq. 13. te pika A.5.5. – Fjalët lapsus – të hiqet fjala "ose komunat".

– Dritan Boçi: – Dakord. E drejtë.

– Agostin Marku: Në fq. 14 – gjenë 2 kolona në

tabelë por nuk është se për çfarë.

- Priton Boçi: Është më lart.
- Agostin Marku: Në fq.16, pika A.7. Taksa të Përkohshme – Se ulet ç'farë këto taksa, nuk thuhet.
- Priton Boçi: Grupi i interesit për i paturndret kjo taksë është biznesi i madh. Është te pika A.7.4.
- Agostin Marku: Në fq.17. te B.1.3.a.2 ka shumëjtur gjuhën për secilën kolonë. Besoj është e panevojshme. Në fq 19. te B.1.3.b.4 të shtohet "b. Përcaktimi i ndarjes së fortës së tarifimit për hotelet e dhomave (numri i dhomave) realizohet nga sektori i verifikimit në terren në DTTV.

Te fq 20. pika B.1.3.c.2. Niveli i Tarifës – shiko atë shumën e tarifës.

Te fq. 21 pika B.2.2. Baza e tarifës për shfrytëzimin të hapësirave publike – Zonën B e kemi vendosur njëjtoj si zonën A – 300 lekë, por duhet bërë dallimi duke qenë se është zonë rurale.

- Albon Laçi – Dr. Urbanistikës – Është për aktivitete ditore me lekë/$m^2$/ditë.
- Agostin Marku: Por prapë nuk shkon. Të jetë zona A 300, Zona B 200, Zona C 100, me lehtësoje, se janë aktivitete në fshat.

Në faqen 24 – pika B.3.4 – Dhënia e lejes për Parkim.

N.p.s Kryetari i Bashkisë ka shprehur shqetësimin për lokalet e dasmave dhe siç e kemi përfshirë, tek këto pushimet private si do trajtohen. – Një llaj takse për këtë gjë të shikohet edhe një herë.
Te fq. 29 – te B.8.2 Ka thënë kështu: lekë/përdorim, duhet lekë/aktivitet ndërsa te fq 28 – te tabela për nivelin e tarifës, te pika 1.e) – kërkesë për shtyrje afati të lejes të bëhet 7000.
Janë vendosur ca tarifa për linjat ajrore për me thënë të drejtën mua më duken shumë të ulta.
- Alban Laçi – Janë për ato linja që kalojnë në pronë publike, jo në pronësi të bashkisë, për t'i disiplinojë kryesisht.
- Agostin Marku: Unë nuk thashë: pse e keni vënë, mua më duken të ulta.
- Alban Laçi: Po duke qenë se është tarifë e re.
- Agostin Marku: Po, dhe më sipër, tarifa për përdorimin e mjeteve të lundrimit, e keni vënë 10.000 lekë. Është luks. Të ulet.
Më fq. 33 te pika D.2. Shuma e familjarëve është njëlloj me biznesin, por nuk duhet të jenë njëlloj, duhet të jetë më e madhe e biznesit, ose t'u bëjmë ulim familjarëve.
- Donika Ndoj: Je duke e goditur biznesin.
- Agostin Marku: Jo Donika, se vrau kep krishtin. Mos ia ulim biznesit por uljë familjarit.

(Flasin pothuajse të gjithë njëkohësisht dhe shkaktojnë kilaritet).

- **Agostin Marku:** Unë e di që ça nuk kam thënë unë do e thotë Frida, por unë nuk kam lënë gjë pa thënë: Drejtor te faqja 34 i ke bosh kolonat.
- **Dritan Boçi:** Shuma është 20 000 lekë dhe përfshin të gjitha përshkrimet e skicave.
- **Agostin Marku:** Dhe e fundit, ke një aneks 4 që ke një 10 fletë me këtë tabelën, ke disa tarifa, për ndriçimin, për dekorin e disa gjëra të tjera. Zonat B dhe C janë më të larta se Zona A. Shikojini se ndoshta është lapsus. Jo në total, por te disa tarifa të veçanta.
- **Dritan Boçi:** Zona B dhe Zona C kanë një specifikë që nuk kanë tarifa gjelbërimi e dekori dhe del që pastrimi e ndriçimi janë në ato parametra.
- **Agostin Marku:** Dhe së fundi, unë e ftoj Këshillin ta miratojmë Paketën Fiskale, me këto rregullimet për aq sa është e mundur dhe uroj që kjo Paketë Fiskale të shërbejë për mbledhjen e sa më shumë të ardhurave që të kemi një buxhet sa më real, efektiv dhe në shërbim të qytetarëve të Lezhës. Faleminderit.
- **Ndue Luli:** Kush ka mendim tjetër?
- **Alfrida Marku:** 2 fjalë, 2 minuta më saktë.
- **Ndue Luli:** Jo 2 minuta, por 3 minuta.
- **Alfrida Marku:** Faleminderit. Shumë urime për

prezantimin e mirë të Paketës Fiskale z. Agostin Drejtor, shumë më i saktë Agostini se se ju në prezantimin e Paketës Fiskale, Pse jo Agostini mund të jetë një kandidaturë shumë e mirë për të drejtuar D.T.T.V në Bashkinë e Lezhës kursen dhe ju kodlyjen se vini vajtje-ardhje nga Tirana.

- Dritan Boçi: Është art më vete shpjegimi.
- Alfrida Marku: Më erdhi shumë mirë që i kthave përgjigje Agostinit për çdo pikë që diskutoi, por më erdhi keq që nuk ishe përgatit për kulturën.
- Agostin Marku: Ishim në konsultë.
- Ndue Luli: Të lutem vazhdo diskutimin.
- Alfrida Marku: ke 15 ditë që drejtorisë tuaj i kërkoj një informacion dhe nuk kemi gjetur mundësinë për të më kthyer përgjigje. Më erdhi shumë mirë që këtu u fol me shifra dhe i pari është kryetari i Bashkisë dhe më erdhi shumë keq që kryetari i Bashkisë këtu është për të dhënë llogari për 113000 banorë të Lezhës. Çfarëdo të them unë, detyra e kryetarit të Bashkisë është për të bërë transparencë. E keni nisur vitin 2019 me propagandë, keni ulur taksat dhe jeni rikthyer në të njëjtat nivele në 2020-2021. Është e zeza mbi të bardhë. Mbaj mend në Shtator 2019, një lajm që i shërben shumë mirë propagandës, shkurtimi i vendeve të punës dhe kryetari premtoi 2 mld lekë investime. Në fakt ju jeni në të njëjtat

nivele të numrit të punonjësve siç e keni fjitur në atë kohë. Ju nuk e keni fituar garën me të kolmarin, ndërkohë jeni kryer shkelje, janë kryer abuzime. Është e disata herë që ta them. Të lutem drejtuesi Prokurorisë për çdo shkelje që konstaton sepse z. kryetar të njëjtën gjë do bëjë ai që do vijë pas jush në krye të detyrës.
Unë nuk mendoj që tokse e pinkolistive që do i dedikohej ndërtimit dhe menaxhimit të pendrave të mbetjes së tretë është pozitiv. Ju në 2019-n keni fjitur 2 pendra të mbetjes së tretë. Një e keni mbyllur.

- Ndue Luli: Faleminderit znj. Marku
Po z. kryetar

- Pjerin Ndreu: 80%-90% e tarifave janë poshtë nivelit të kohës sonë, mos janë borxh, por asnjë-herë më të larta, se nuk ke mundësi sepse ju i keni pasë maksimale. Para reformës terri-toriale numri i punonjësve i bashkisë dhe komunave ka qenë gjithsej 578 ose 575. Ju vetëm me VKB ju keni pasë në vitin 2018 - 616 punonjës. Janë fjitur 140 vetë me kontrata provizore. 581 e keni pasë në 2019, 437 e keni ul në 2020, 469 ka shkuar në 2021, 468 e keni pasë në 2022 dhe 504 në 2023-shin. Pra, sot jemi 102 vetë më pak se ti. 249 ke pasë funksione të deleguara që paguan qeveria në 2019,

Në të gjithë këto që thamë deri tani dhe që ju zonjë më etiketoni mua, ne nuk kemi asnjë rast që të kemi dalë mbi taksën që ke pasur ti. Dhe megjithëse ne i kemi ul taksat më shumë se ty, prapë jemi më shumë në mbledhje se ju atëherë. Për të tjerat flasim më vonë pastaj. Se nuk na lënë shifrat të gënjejmë.

- Ndue Luli: Faleminderit kryetar.

Fjalën e ke z. Ndreu.

- Artan Ndreu: Përshëndetje kryetar i Bashkisë.

Përshëndetje kolegë. Të lutem znj. Alfrida mos na nxirr jashtë këshillit, jashtë shinave. Unë dua të diskutoj për 2-3 gjërave. Dëgjova për vetëdeklarimin por një pjesë e fshatarëve nuk dinë as të shkruajnë, as të lexojnë. Nëse realizohet, jam shumë dakord. Për pastrimin e zonave, ju keni marrë përsipër pastrimin edhe në fshat, është e parealizueshme ta bëni me thasë për arsye se fshati ka kafshë të buta, dhe kerosinin. N.p.s është e mundur që për çdo fshat të grumbullohen ose të digjen. Znj. Alfrida, kryetarin e Bashkisë e kemi më të mirin se ka sjellë 75 mln euro për 4 vjet. Faleminderit.

- Ndue Luli: Z. drejtor e ke fjalën për një sqarim

- Dritan Boçi: Kryetari i Bashkisë synon që tëketë një taksim se më të drejtë. Për të marrë të dhënat ekzakte mbi truallin ose ndërtesën ose tokën bujqësore për çdo familje, do jetë nëpërmjet formularëve. Do

punojmë në terren,posaçë ne, posaçë njësitë, por mund të ketë taksapagues familje që janë të orientuar me teknologjinë. Çështje që shihet me interes është tejkalimi i afateve dhe penalizimi nga sistemi. Mendojmë që gjatë vitit financiar mund të vihet me një propozim tjetër për shtyrjen e efektit të penalizimit.

- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Kosova.

- Saveljon Kosova: Unë nuk kisha shumë për të diskutuar, megjithatë desha për kryetarin. Të gjitha shkeljet që mund të konstatohen në periudhat paraardhëse kryejt është jashtëzakonisht e rëndësishme, detyrim t'i shtroni te institucionet e përcaktuara. Është mirë që dhe debati këtu mos të kalohet dialog, nuk na vlen as ne si grup, as si këshill, as për trajtim, as për vendimmarrje. Z. nënkryetar e kaloi pikë për pikë dhe përgjithësisht jam dakord me ato që tha. Edhe kohët që ju diskutoni dhe krahasoni, realisht janë shumë të ndryshme. Kemi parë dhe një sfidë: ka pasë riorganizim i bashkive dhe komunave në një sistem tjetër para 5 viteve dhe nuk bëhen kritikat kështu bombastike, megjithatë dhe mënyra e asaj administrate nuk mund të jetë ashtu bombastike.

Në lidhje me Paketën Fiskale, realisht është e dukshme që ka rënie të tarifave. Po të duash t'i mbledhësh, duhet t'i ulësh ato. Nuk mund të rrimë e të krahasojmë ti e ke pasë kap e unë aq sepse asnjëra logjikë nuk shkon te tjetra. Bashkia është

një institucion, ka të zgjedhur dhe nuk është me ti e me unë e me ai.

- Ndue Luli: Po z. kryetar.

- Pjerin Ndreu: Paraprakisht jam dakord me atë që tha z. Kosova. Ndërsa mua më kërkohet shifra duke më anatemuar publikisht se unë kam nxitur tonset, do jap përgjigje. Nëse këtu dikush do të bëjë politikë, do të bëjë protagonizëm, do të marrë medalje trimërie, do të ecë në karrierë, do të bëhet dikushi e ju sfumon ju, është problem i juaji si opozitë. Unë këtu përveç se jam kryetari i Bashkisë, jam dhe njëri politik. Nuk kam shkuar asnjë me çu në organet e drejtësisë asgjë, por nëse më kërkohet publikisht t'i them, do i them. E thashë gjithashtu që dhe ne kemi problematika sot. Ajo që është thelbësore është a i kemi ngritur apo i kemi ulur? Po i rëndojmë biznesin dhe familjarët apo s'po i rëndojmë?
Në konsultim Zotëri, se nuk ke qenë aty, zonjë, në vend që të më lute të merreshe me të tjerët, erdhi dhe bëri debat sikur jemi në këshill. I thashë mos të bënim këtë debat por e bëri. Tha ke nxitur tonset. Fliste për një vendim, që nuk e thoshte dot se cili ishte. Unë do jap përgjigje dhe po të them, kush do të bëjë politikë dhe unë do bëj politikë. Nuk kam frikë asgjë n.q.s ju nuk me keni kërkuar ose s'më keni nxjerrë. Gjeni kush është lideri, kush i di më mirë këto gjëra.

- Ndue Luli: Znj. Hoxhia.
- Donika Hoxhia: Atëherë shumë shkurt. Jo për të bërë protagonisten. Jemi dhe grupe të ndryshme këtu në këshill. Së pari, kisha tërhequr vëmendjen për disa batuta që mua nuk më duken shumë normale. Unë sigurisht i kam parë këto tabelat. Jam e mësuar të besoj në profesionalizmin e ekonomistëve, sigurisht që di t'i lexoj numrat, nuk jam për të bërë krahasime, në gjykimin tim si qytetare por edhe politik asnjë bashki nuk duhet të krahasohet me bashkinë e mëparshme por vetëm me premtimet e veta. Në momentin që ke fituar e ke bërë dikush tjetër dallimin dhe zgjedhjen. Ishin më të larta, janë ulur dhe kanë shkuar prapë atje, kështu që e shoh të kotë diskutimin më gjatë në lidhje me këtë. Dhe diçka tjetër po e them si qytetare, të gjitha këto taksa të vihen në shërbim të qytetarëve, kjo është ideja. Të na krijohet mundësia të ecim si njerëz në një qytet që ke emrin të tillë. Në mbledhjen e kaluar ishte nënkryetari i bashkisë dhe përmendi investime madhore. Unë përmenda përmbytjet e shkollave. U përmbyt shkolla prapë. Ju lutem, sipas mundësisë të shikoni ato pusetat që të shmangen përmbytje e madhe, pastaj ato investimet e mëdha shqyr që janë.
- Ndue Luli: Fjalën në vijim e kanë z. Troshaj dhe z. Ndreca. Po z. kryetar.

- Pjerin Ndreu: E pose, nuk është e vërtetë se ne i kemi ngritur prapë në atë nivel taksat, ke 1-2 taksa që janë ngritur dhe nuk ke asnjë taksë tjetër që të ketë shkuar në atë nivel, një ishte me VKM, ishte e detyrueshme. Jam shumë dakord me ju që të kërkojmë shërbime. Po, bashkia ka shumë për të bërë në dhënien e shërbimeve, ndërsa përmbytja do zgjidhet kur të vijë KFW gjermane e të bëjë sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza e të bardha dhe për hir të saj ne jemi kapitur në investimet edhe në disa lagje të qytetit. Sinqerisht i mirëpres edhe vërejtjet t'i thoni sepse në fund të fundit për këtë jemi në këshill. Dhe nëse doni me marrë medalje politike, edhe unë askush do i jap përgjigjet.
- Alfons Trashaj: Përshëndetje z. Kryetar
Flas për biznesit. Unë kam një biznes të vogël por do ta them në përgjithësi. Unë nuk kam pasë rritje taksash. I kam paguar rregullisht. I kam të rregjitura të gjitha. E kemi diskutuar dhe në zyrën tënde. Unë kam pasë një shtesë që nuk më shërbehet, s'kam pse ta paguaj atë. Unë kisha një kërkesë, për të gjitha zonat administrative dhe në qytet, një faqe elektronike ku të nxirren gjithë bizneset që paguajnë dhe ato që nuk paguejnë dhe ta marri vesh çdo qytetar. Nuk ke pasë kontrolle nga ju fare se mua nuk më ke ardhur askush te biznesi për

të kontrolluar sa $m^2$ kam. Mospagesa e taksave është në nivel shumë të madh

- Driten Boçi: Informacioni që ju kemi sjellë me shkresë ka qenë shterues, por nuk na lejon ligji që të nxjerr emrat e subjekteve.
- Ndue Luli: Tani një minutë e ke fjalën z. Tushaj
- Pjetër Tushaj: Përshëndetje dhe njëherë. Kam 28 vjet në biznes dhe mirë kam kaluar. Taksat dhe tarifat janë kyçsorët për njerëzit që e kuptojnë. Unë i kam paguar gjithmonë taksat. Kjo paketë fiskale, mua më interesoni si biznes.
- Ndue Luli: Faleminderit z. Pjetër.
Fjalën e ke z. Ndreca.
- Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve. Dua ta nis me një vërejtje për kryetarin e këshillit pasi neve si mazhorancë nuk po na respekton (shkelton hilaritet). Shoh që këtu vazhdojmë të përsëriten të njëjtat gjëra, e kalojmë në dialog, e kalojmë në muhabet shtëpie, dhe z. kryetar ta kam përsëritur shpesh, këtu ka njerëz që vijnë për të shtyrë kohën, nuk janë aspak profesionalë, mundohen të na hedhin hi syve, mendojnë se nuk dimë të bëjmë llogaritë mirë. Përkundrazi, jemi shumë të porsit, shohim, dëgjojmë dhe krahasojmë. Dua të them dy mendime në emër të koalicionit të mojitë në raport me Paketën Fiskale të prezantuar. Kam marrë pjesë te dëgjesa për prezantimin e Paketës

Fiskale, me biznesin. Kam marrë pjesë edhe herë të tjera por një që kam parë këtë radhë ishte një pjesëmarrje e jashtëzakonshme nga biznesi, që do të thotë që keni vlerësuar Bashkinë e Lezhës për shërbimet që u ka ofruar për zhvillimin e këtyre bizneseve, edhe zotërinjtë këtu të pranishëm e pranuan që kjo paketë fiskale është ndër më të mirat të paraqitura. dhe disa përpiqen të na hedhin hi syve se jo nuk është kështu, nuk besoj se na lë vend shumë për të vazhduar pastaj me tema personale, nga njerëzit që, p.sh. po marrim zonjën Alfride që s'është as e fushës, që po shikoj dhe një nga propozimet e saj: zbritjen në 30% të taksës për tokën bujqësore, për sa kohë infrastruktura vaditje-kullim nuk është funksionale në çdo zonë. - Kjo do të thotë thjesht propagandë. Paketa Fiskale është një dokument që përfshin të gjitha problematikat për taksat e tarifat e bashkisë. Falenderojmë bashkinë dhe drejtorin e D.T.T.V. që ka bërë një punë shumë të mirë. Ju ftoj që të vazhdojmë te hedhim në votim dhe ta votojmë.

- Ndue Luli: Unë i pranoj kritikat.

Meqë erdhëm në fund, se ka 1 orë e gjysmë që diskutohet për këtë p/vendim, kush është dakord që ky p/vendim të kalojë së bashku me ato ndryshimet që dolën gjatë bashkëbisedimit të kryetarit të komisionit të Financës dhe drejtorit

të Drejtorisë së Taksave?

Miratohet me 27 vota PRO, një KUNDER nga këshilltarja Alfrida Marku dhe një abstenim nga këshilltarja Donika Haxhia.

Vazhdojmë me projektvendimin "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 13, dt. 27.07.2023 "Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave"".

Në lidhje me këtë, fjalën e ka kryetari i komisionit.

- Agostin Marku: Është një p/vendim nga Bashkia Lezhë. Ka një strukturë të posaçme dhe duhet që ne t'i vendosim dhe pagën sipas grupeve të caktuara që ka klasifikimi i pagave, për ato pozicione. E gjejmë në përputhje me ligjin dhe mendojmë që këshilli duhet ta miratojë.
- Ndue Lul: Meqë nuk ka ndonjë mendim tjetër, kush është dakord me projektvendimin?

Miratohet me 28 vota PRO. Këshilltarja Alfrida Marku nuk votoi.

Kalojmë te projektvendimi "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave të shërbimeve në vijën bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2024".

Fjalën e ka kryetari i komisionit të Urbanistikës

- Erin Ndreca: Sipas grafikut të mbledhjeve të komisioneve, edhe Komisioni i Urbanistikës u mblodh

për këtë projekt vendim që ka të bëjë me miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve. Në mbledhje ishin dhe drejtuesit e D. së Urbanistikës, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për pjesëmarrjen. U diskutua për arsyet e ardhjes së këtij projektvendimi në këtë moment i cili ka të bëjë me afatet ligjore të përcaktuara, pasi gjithmonë bashkia është gjendur përballë vonesa në këtë menaxhim, ku sipas diskutimeve është parë që gjithçka është brenda normave dhe është vendosur që ky p/vendim të kalojë për vlerësimin e këshillit. Nuk kishte vërejtje nga të pranishmit, prandaj ju ftoj që të votojmë.

- Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Kush është dakord me p/vendimin? Miratohet me 27 vota PRO dhe 2 vota abstenim nga këshilltaret Alfride Marku dhe Donika Hoxhia.

Kalojmë te projektvendim "Për miratimin e Komisionit Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në Bashkinë Lezhë". Krijimi i këtij komisioni është kërkesë e rregullores që kemi miratuar. Ju kujtoj që jemi në prag të zgjedhjeve së strukturave komunitare. Ju bëj thirrje që të tregoheni të gatshëm për zbatimin e kalendarit që kemi miratuar të gjithë së bashku. I bëj thirrje bashkisë që nëpërmjet kryetarëve të njësive administrative të bëhen në kohë

mjeftimet.
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 27 vota PRO, 1 votë kundër nga këshilltarja Alfrida Marku dhe këshilltari Sovejan Kosova nuk votoi.
Kalojmë te projekt vendimi "Për ndryshimin e emërtimit të rrugës nga "Çamëria" në "Zef Toma"
Sa për dijeni kjo është një kërkesë që në muajin mars, para zgjedhjeve dhe për arsye të fushatës elektorale nuk e kemi paraqitur në këshill dhe për arsye të ngarkesës së madhe që kemi pasur këto 2-3 muajt e parë. Këtu bëhet fjalë për rrugën te lokali SIKLAD, në anën andej të bregut të Drinit.
Është pyetur komuniteti për t'ia vënë emrin "Zef Toma", i cili ka qenë një nga mundësit kampion kombëtar.
Kush është dakord me këtë p/vendim?
Miratohet me 28 vota PRO. Këshilltari Rrok Marku nuk votoi.
Projekt vendimi tjetër është "Për ndryshim dhe emërtim rrugësh në fshatin Gajush".
Aty është një rrugë me emrin "Luigj Dedë". Është parë nga ne kryesia e këshillit, së bashku me kryeplakun dhe Drejtorinë e Urbanistikës në hartë.
Bëhet fjalë që jo të hiqet fare emri "Luigj Dedë" pasi aty ka shumë kryqëzime, përcaktohet pjesa që do mbajë emrin "Luigj Dedë" dhe kjo rrugë

për të çuar në lagjen "Gjonaj" të mbajë emrin "Gjonaj".
Është bërë takimi me banorët.
Kush është dakord?
Miratohet me votat PRO të të gjithë këshilltarëve prezentë, pra 29 vota PRO.
Pika tjetër e rendit të ditës është projekt vendim "Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për Zotërinjtë Frano Kulli, Ismet Zusi, Nikolin Ivanaj, Marash Marku, Qemal Minxhozi, Salvator Gjiçi".
Dokumentacionin e keni pasë të gjithë.
A ke kush diçka?
- Agostin Marku: Unë kam diçka, në parim jam dakord, kështu ka gjykuar Kryetari i Bashkisë. por nga ana procedurale ky p/vendim duhet ndarë në 6 vendime, sepse secila nga figurat e ka më vete titullin dhe motivacionin. Sepse n.p.s ndonjëri këtu nuk është dakord me ndonjërin nga figurat, s'kemi pse të votojmë gjithë vendimin. Kam të zbardhet, të jetë gjithsecili në vendime të veçanta.
- Ndue Luli: Kush është dakord, me ndryshimin që të jenë më vete?
Miratohet me votat PRO të të gjithë këshilltarëve prezentë, pra 29 vota.
- Z. Artan Nazreu kërkon sqarime për figurat.

- Pjerin Ndreu: Me rastin e inaugurimit të Pallatit të kulturës që ne shpresojmë të kemi pati në datën 27 nëntor, mendruam të nderojmë disa nga figurat e artit e të kulturës në Lezhë, ku përjashtim bën z. Qemal Minxhozi i cili është një promotor i madh i qytetit tonë në gjithë trevat shqiptare, sidomos në Kosovë, në detyrën e tij të ambasadorit.
- Arton Ndreu: Dhënia e titujve është një gjë shumë e rëndësishme. Në këshillin e kaluar kemi pasë një 3 raste që unë nuk i kam votuar. Kjo është një hije që mbetet. Duhet të përzgjidhen këto dy figurash, për mendimin tim.
- Pjetër Noka: Shikoni atë bustin aty, para bibliotekës.
- Agostin Marku: Ne e kemi bërë bisedë edhe me kryetarin e Bashkisë, por edhe ne duhet t'i përkushtohemi kësaj pune që të bëjmë një sistem të ri të adresave, ku hyjnë sheshet, rrugët, bustet e gjithçka, sepse për këtë gjë çalon në fakt, jo vetëm Bashkia e Lezhës, por bashkitë e gjithë Shqipërisë.
- Ndue Luli: Në lidhje me informacionin për njohje, mbi zbatimin e buxhetit për 9-mujorin 2023, e keni parë të gjithë materialin. A ka ndonjë diskutime në lidhje me të? Meqë nuk ka, kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës që është interpelancë me Kryetarin e Bashkisë

z. Pjerin Ndreu për gjendjen ekonomiko-financiare të Bashkisë Lezhë, kërkuar nga këshilltarja znj. Alfride Marku.
Unë, si drejtues i mbledhjes, duke parë se shumë problematika u trajtuan gjatë diskutimit të Paketës Fiskale, mendoj të jeni sa më konçizë në atë që do diskutohet. Znj. Marku e ka fjalën.

– Alfride Marku: Faleminderit. Me shkresë zyrtare kam kërkuar që ju si drejtues i institucionit që menaxhoni të ardhurat e bashkisë, të bëni transparencë për qytetarët për gjendjen financiare të Bashkisë Lezhë, sa ishte parashikimi, sa keni parë transfertat nga qeveria dhe ku keni shkuar këto para. Kam kërkuar të raportoni në këshill mbi gjendjen financiare të bashkisë, referuar nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", duke shtuar dhe faktin që jemi dhe në proces diskutimi për PBA-në e 3 viteve të ardhshme dhe buxhetin vjetor 2024. Sipas dokumentit të vënë në dispozicion nga ju "Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë 2023", realizimi i të ardhurave për 8-mujorin 2023 është 52,3 % ose 349 mln lekë më pak nga sa ishte planifikuar, që këtu kemi shifra kontradiktore, gjë që konfirmohet nga raporti i KLSH-së ku sipas tij konfirmohet se vetëm gjatë 4 muajve të parë të vitit 2023 janë konstatuar 430 mln lekë më pak lekë nga taksat e tarifat

vendore, pra në raportin që ju paraqitni, shifra
është më e ulët. Në këtë raport konstatohet se
për disa taksa e tarifa realizimi është në vlera
më të ulta, ndërsa për disa taksa e tarifa të tjera
realizimi paraqitet mbi planin, me ndryshime të tilla,
për të njëjtën taksë nga njëri vit në tjetrin, gjë
që tregon që planifikimi i të ardhurave nuk është
real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar
drejtpërdrejt negativisht në realizimin e tyre. Nuk është qëllimi
im për të politizuar argumentet, por e vërteta duhet
thënë. Neglizhenca apo harresa e qëllimshme për të
mbledhur taksat dhe tarifat te bizneset kryesisht,
dëmton interesat e qytetarëve sidomos të atyre
që janë gjithmonë korrektë për detyrimet ndaj bashkisë.
Taksapaguesit kanë të drejtën që me taksat e tyre të
bëhen të mundura shërbime të reja apo përmirësimi
i atyre ekzistuese. Por nëse referuar KLSH, për vitin
2020 ke pasur mosrealizim të të ardhurave në
shumën 287 mln lekë dhe për vitin 2021 mosrea-
lizim të të ardhurave në shumën 168 mln lekë.
Dyshimi im se mosrealizimi i të ardhurave në
4 mujorin e parë të vitit 2023 në shumën 402 mln
lekë, ndikuar nga fushata zgjedhore, ka gjasa
të jetë më se i arsyeshëm. Shtuar dhe faktin se
në fund të 2020-ës numri i debitorëve ishte
5451, në fund të 2021 - 4449 në vlerën
241 mln ndërkohë në 4 muajt e parë të

këtij viti 402 mln lekë. E gjithë kjo, neglizhencë e qëllimshme apo paaftësi ka ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizim të shpenzimeve, apo te cilësia e shërbimeve. Shpenzimet kapitale apo investimet janë realizuar në masën 48 % ose 163 mln lekë më pak. Për 4 mujorin e dytë shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 47 % ose 209 mln lekë më pak, thënë ndryshe, keqmenaxhimi u ka kushtuar banorëve të Lezhës mungesë përmirësimi të shërbimeve si dhe 372 mln lekë investime të munguara. Po ku shkojnë taksat tona? Do ju jap një shembull. Vetëm të periudhën janar - shtator 2023 janë prokuruar punë dhe shërbime publike në vlerën e 62 mln lekë të klasifikuara këto si të zhvilluara në kushtet e mungesës së konkurencës apo skualifikim i gjithë operatorëve, përveç fituesve. Vetëm në datat 6-18 shtator, në kushtet e mungesës së konkurencës dhe skualifikimit të të gjithë operatorëve, përveç fituesit, janë prokuruar 33 mln lekë. Në vijim të po të njëjtës pyetje: ku shkojnë taksat tona? - unë do shtroj disa pyetje për të cilat transparenca bën vetëm mirë sepse janë pikëpyetje që qytetarët i kanë. Sa projekte, investime ka kryer Bashkia Lezhë me të ardhurat vendore të vetë bashkisë? Po nga buxheti i shtetit, çfarë është bërë me fondet e rindërtimit? A janë thirrura dhe sa herë janë marrë në pyetje nga organet e

drejtësisë drejtues të strukturave të Bashkisë Lezhë dhe
të njësive administrative për lista fiktive apo ndryshim
të kategorisë së dëmit të shkaktuar? A është e
vërtetë që sot në prokurori po hetohen 240 raste të
ndërtimeve pa leje të cilat i keni toleruar dhe lejuar
në periudhën e fushatës zgjedhore dhe ndërkohë sot i
keni përplasur para institucioneve të drejtësisë?
Se investime janë kryer në Bashkinë Lezhë në
vitin 2023? A ishin të gjitha të parashikuara në
buxhetin e miratuar të vitit 2023? A janë kryer
punë publike pa qenë të përfshira në buxhet?
Një çështje e fundit që do doja të ndalesha - keni
përmendur në të gjitha analizat që ju paraqitni,
mungesën e lejeve të ndërtimit, një ndër arsyet e
mosrealizimit të të ardhurave. Ju mbase e konsideroni
pengesë por ndalimi përfundimisht i lejeve të ndërtimit
në zonën ekzistuese, referuar planit të qytetit Lezhë,
dhe të Shëngjinit dhe zgjerimi drejt zonave të reja
me standarte bashkëkohore, duhej të ishte një masë
emergjente për t'u ndërmarrë, ndryshe Lezha dhe
Shëngjini do të jenë shumë shpejt shumë beton, pa
standarte bashkëkohore dhe pa zhvillim. Por, ju
z. Kryetar keni vepruar tërësisht të kundërtën. Me
vendimin nr. 231, dt 31 mars 2023 keni ndërmarrë
nismën për rishikimin me procedurë të përshpejtuar
të Planit të Përgjithshëm Vendor. Në këtë vendim-
marrje ju nuk argumentoni asnjë shkak të arsyeshëm

që ju ka kushtëzuar për të vepruar kështu si dhe impakti që do ketë te banorët e Bashkisë Lezhë por pas një pseudodëgjese 1 orë me 25 persona, K.B. Lezhë ka miratuar këtë hisme me vendimin nr. 24, dt. 25.04.2023. Interesi më i lartë dhe prioritetet e mbi 113 mijë banorëve nuk mund të përcaktohen nga vendimmarrje të nxituara dhe të pakonsultuara. Si përfundim, nxitimi juaj për të ndryshuar PPV në kohë fushate do i kushtojë Lezhës dhe banorëve të saj si vijon: shtesa me 2-3 kate, 3 kat pallate ekzistuese në qytetin e Lezhës, 8800 m² ndërtim i shtuar në zonën e aneksit, me njësi shërbimi deri në 3 kat, 3900 m² ndërtim i shtuar në hapësirën e stadiumit me njësi shërbimi deri në 1 kat, zëvendësimin e lulishtes pranë ish-telekomit me beton, me njësi shërbimi deri në 1 kat, 55000 m² ndërtim i shtuar në zonën afër Portit të Shëngjinit si dhe 302000 m² ndërtim i shtuar në zonën e Kunes, zonë e cila rrezikohet dhe nga erozioni, siç edhe e dini.
Në total në qytetin Lezhë dhe Shëngjin, nga rishikimi i PPV me procedurë të përshpejtuar do shtohen jo më pak se 376000 m² sipërfaqe ndërtimi. Kaq kisha.

- Ndue Luli: Znj. Marku kam një pyetje. Pyetjet që ti drejtore nëpërmjet leximit të materialit: a janë dërguar te kryetari i Bashkisë në mënyrë

pse ai t'i mbahet atyre pikave?

- Alfrida Marku: N.p.s kryetari kërkon kohë, unë ia nis me email.

- Ndue Luli: Dmth nuk janë nisur.

- Pjerin Ndreu: Kur më kërkon mua shifra, duhet të më dërgojë një material që unë të përgatitem. Sa investime, sa projekte janë bërë me fondet e bashkisë etj, fondi i rindërtimit - sa herë ne ke folur ne prokurorie - asnjëherë p.sh, se kjo ka qejf, tu prit me zor se kur do më kapin mua, bashkë me ca që i shkojnë rrotull.

E para e punës, është një tjetër rast për të treguar se zonja Dedgjonaj nuk e kupton fare buxhetin. Thotë që ka një raport që kemi gjellë që na mungojnë diku te 370 mln të ardhura dhe një ore tjetër thotë - për 4-mujorin e parë kjo shifër është 402, Se çfarë kur i referohesh raportit të KLSH ai është një buletin që del në 4 mujorin e parë por nuk ka asnjë konstatim për 2023-shin., e çfarë më pak për vitin elektoral. Sa për vitin elektoral që thua ti se ne paskemi mbyllur sytë në vitin 2022, që nuk ishte vit elektoral, ne kemi transferuar 2,2 mln dhe në vitin 2023 që jemi 2,6 që bie poshtë një fantazia jote dhe deri tani, për 8 mujorin ne kemi mbledhë 2,6, pra kemi mbledhë gati 80% të shumës, por nuk kemi taksin e

infrastrukturës, pra është një e ardhur shumë
e madhe, që besoj ti e ke mësuar kaq gjë në
bashki, që po të mungojë një të vë në vështirësi;
megjithatë nëse do shikimin tonë financiar,
se ti merr për referencë vitin pandemik, po
normalisht do thellohesh në debitë, por ne kemi
ulur shpenzimet, kemi ulur pagesat te fondi i
pagave, kemi ulur atë pjesë që i jepnit ju
kulturës, kemi ulur disa shpenzime të tjera, kemi
larë borxhet. Ju nuk keni bërë një vlerësim
të dokumentacionit të ish komunave - e ke
dhe te raporti i KLSH, një administratë e tërë
4 vjet nuk ka parë për të vlerësuar se nga
këto dosje kanë dokumentacion që mund
të likuidohen. Ne i kemi parë 1,2 nga 1,5 mld
i kemi hequr me vendim këshilli. Nuk mund
te mbart unë një borxh që nuk kam për të
fare dokumentacion. Deri në dt. 31.12.2022
ne jemi debitor vetëm me 370 mln lekë të vjetra.
Kemi performuar shkëlqyer. dhe 280 mln janë
vetëm të ujësjellësit. E kemi borxh të brendshëm.
Mapë do gjendjen financiare tani, unë të them
ty, janë 2 aplikime në proces, 100% njëri
kalon para vitit të ri dhe tjetri mbas vitit
të ri. Janë 3.5 mld taksë infrastrukture.
Janë dhe 10 aplikime të tjera që bëjnë edhe
një 5 mld por që shtrihen në vitin tjetër.

Raporti i KLSH nuk reflekton 2023-shin, se ne jemi konsultuar me ta, se ata kanë bërë dhe një gafë aty – 44000 mijë biznese, n.q.s e ke lexuar mirë, atje nuk i ka Tiranë, ke një lapsus aty, për të cilin ne kemi kërkuar sqarim. Nëse do të bindesh për atë shifër, drejtoju KLSH-së ose kurdo të takojmë në aty me ta.

Eshtë fitore shtrirje e borxhit që nga 2010-n që ta dish ti, që ia kanë bashkuar subjektet të tëra që ti nuk i ke mbledhur, ai para teje nuk i ke mbledh, unë s'i kam mbledh, që kam mosrealizim të ardhurash. Ne kemi menaxhim të ardhurash, se ne nuk kishim si të binim nga 4,6 mld në 370 mln. Vitin 2023 ta shohim. Presim taksën e infrastrukturës. Eshtë resort 70 mln euro. Kemi parashikime optimiste por që nuk janë realituar deri tani. Ti merr si referencë vitin pandemik, por nuk mund të më thuash mua: pse nuk i ke futur thonjtë në fyt biznesit, i cili ishte i mbyllur. Se ti harron kontekstin e kohës. Kemi kaluar tërmetin, kemi kaluar pandeminë, kemi kaluar dhe krizën e rëndë ekonomike, që ishte një tjetër barrë që ne e kemi kaluar në kurriz, pra ajo që tha z. Kosova, që nuk ngjajnë kohët, nuk ngjajnë. Ne kemi pasë trauma të rënda që kanë lënë pasojë në marrëdhënien tonë me të ardhurat.

Në raportin e investimeve me buxhetin tonë, ne jemi ndër bashkitë më të mira në Shqipëri. Dhe në raportin e Ministrisë së Financave, ne vijmë, nga e kuqe, kur e kemi marrë, në portokalli, vijmë në jeshil. Ta vëmë në dispozicion n.q.s do ta shohësh, që s'kam faj, nuk gabon ajo, nuk i bën sipas qejfit tim e as tëndit. Unë kam fatura që do i laj me 2 lejë që kam dhe mbaroj punë. Unë po të them që brenda marsit dalim përpara. Në mars do i sjellim në Këshill dhe do shikoni sa likuidime vijnë për shkak të tepricave. Situata financiare e bashkisë është e shëndoshë. Ekuilibri mes fondit të pagave, shpenzimeve operative dhe investimeve me fondet e gjeneruara nga ne – po të them që jemi ndër bashkitë që kemi balancën më të mirë, se cilla bashki ke mbajtur ekuilibër strukturor, ekuilibër financiar dhe investimesh.

A ke probleme? A ke gjëra që nuk shkojnë?

- Po, ke sa të duash. Unë kam konstatu që nuk kemi pasë gjithmonë sa duhet ndaj investimeve. Do ngremë një grup pune me Urbanistikën që të monitorojë investimet në proces. Investimet që kam nga Fondi i Zhvillimit nuk i kam marrë në dorëzim, që ta dish ti, as bregun e Drinit, as Lalmin, për shkak të cilësisë së trotuareve, për mua nuk janë ato të duhurat. Po të shikosh trotuarin që kam bërë unë në pendër, është komplet tjetër gjë, me punonjësit e bashkisë.

Është cilësi super. Kjo është problematikë për nuk
më ka ndodhur vetëm mua por jemi duke e parë.
Në lidhje me taksat – as ti, as unë nuk po kemi
çuar faturën në zonat rurale, sepse nuk kemi bazën
e të dhënave të tokës bujqësore, të ndërtesave,
duhet të kërkojmë vetëdeklarim se nuk kemi
rrugë tjetër. Me sistemin elektronik do i çojmë
faturën se e meriton, prandaj ne ç'edojmë me të
ardhurat në të gjitha zonat rurale, ku në 9 mijë
familje Shënkoll-Fejmen-Kodsh, e di se paguajnë?
400 e ca. Kjo normalisht na ngarkon me përgji-
gjësi. Nuk është eficiencë, por në këto kushte jemi.
Ky sistem është në përmirësim. Ne duhet të japim
receta për përmirësim, jo të gjejmë gabim. Të dyja
palët gabim e kemi bërë. Bëntosin njerëzit në zonat
rurale, kërkojnë rrugë, por me çfarë bëhen ato?
Me taksa. Duhet futur kjo edukatë dhe kemi
shumë për të bërë. Në aspektin financiar, e bëjmë
materialin pa merak, t'i japim me shifra. Në
financa ne jemi të sigurt sepse kemi bërë diçka,
kemi strukturuar organikë, kemi ulur shpenzimet e ndryshme.
Po të kisha taksën e infrastrukturës, me investimet
e mia unë do isha ku e ku para.
– Zoj. Marku citon VKB me të cilin janë hequr
nga kontabiliteti borxhe, pra nuk janë paguar
por thjesht janë hequr për mungesë dokumentacioni
justifikues.

- Pjerin Ndreu: 6,8 të ka lënë KLSH në 2017-n. E ke ulur për shkak të taksës së infrastrukturës që more. Këtu te 4,6 ke pasë edhe 1,5 borxhe të ish komunave. Ty të ka lënë KLSH detyrë që ta vlerësosh atë, por nuk e ke vlerësuar. E vlerësuam ne, dhe doli që për 1,2 nuk ka dhe nuk kam pse e mbaj si borxh. Edhe ti po të vish në bashki, nuk i paguan dot ato lekë.
- Alfride Marku: këto borxhe duhet t'i zeronte qeveria.
- Pjerin Ndreu: Po, jam dakord.
Nuk i zeroi qeveria, i zerova unë me VKB.
- Ndue Luli: Jemi në pikën e fundit "Të ndryshme". Mund të merrni fjalën për problematika që vërtet janë urgjente. Fjalën e ka z. Soreljon Kosova.
- Soreljon Kosova: Dy fjalë shkurt. Sezoni i dimrit po afrohet. Bujqësia është ndër sektorët më të rëndësishëm të Bashkisë Lezhë. Është fakt, që nuk kam pse ta mohoj, që është bërë shumë punë me kanalet, këtë e kam nga eksperienca si banor i njësisë Balldre. Kjo nuk do funksionojë nqs kryetari i Bashkisë nuk e ka nën sy te hidrovoret, veçanërisht se nuk është kompetencë e tij, aty ka neglizhenca të papara në momente të caktuara. Sikur t'i hapësh gjithë kanalet e Torovicës, me një kapmenaxhim 3-orësh, gjithçka bie poshtë. E di që mundesh të interesohesh.

Edhe në hidrovore të tjera kam informacion për
ka keqmenaxhim ujëtitor. Është e mundur për
të bëhet minimizimi i problematikave të përnjëherë
- Pjerin Ndreu: Jam shumë dakord me problemin
e hidrovorit të Torovicës
- Sovejçin Kasora: Përveç problemit, ka posë dhe
keqmenaxhim ujëtitor.
- Pjerin Ndreu: Hidrovori i Balldrenit ka pasë
njëherë një problem për e di ujë, një mosreagim
në kohë reale të ndezjes së pompave, dhe në
bazë të të dhënave janë 5 km pa janë hapur.
Edhe në Torovicë e Gocaj janë hapur shumë
por nuk mjaftojnë. Hidrovori ka një problem.
ka dalë sipër nivelit të tokës, dhe gjithë ajo
zonë përreth bëhet det. Nuk ka zgjidhje tjetër,
vetëm hidrovor i ri. E kemi diskutu me perevinë.
Fusha e Torovicës atje e ka lavdinë. Nëse ne do bëjmë
hidrovorin, ne do shpëtojmë dhe do të bëjmë produktive
dhe ujërat do mbjellin. Keqmenaxhim ujëtitor, po, kemi
posë problem një me hidrovorin e Tales
Që të gjithë po folët për energjinë elektrike, keni të drejtë,
është e vërtetë.
- Z. Alfons Treshaj shtroi problemin e hedhjes së mbeturinave
afër burgut dhe përmendi një problem në lidhje me rrugën
e Zejmenit ku kalojnë trajlerat me ngarkesa të mëdha
për po e shkatërrojnë.
- Kryetari z. Ndue Luli deklaroi mbylljen e mbledhjes.
- Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli
i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**
**Protokolli**

**Kartelë shoqëruese e praktikës**

**I.Dërgues** Alfrida. Marku. kryetare e Grupit këshilltarëve të P.D.
Nr.________Prot., Datë 27 . 10 . .2023

**II.Marrësi : Bashkia Lezhë** Nr. 16408 Prot., Datë 30 10 . .2023
Përmbajtja : Propozime për ndryshim Projekt-Vendim

**III.Për t/u trajtuar nga :** 1. KESHILLI BASHKIAK Datë ____/____/2023
2.________________

Shënim i Kryetarit ________________________________

**Afati kthimit të përgjigjes:** ☐ 7 ditë ☐ 5 ditë ☐ 3 ditë ☐ 2 ditë ☒ Urgjent (brenda ditës)

**Firmë**____________

*IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse* ____________, *Datë* ____/____/2023
**V.Për t/u trajtuar** nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës ____________, Datë ____/____/2023
Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: ________________________________

**Firmë**____________

**VI. Marrë në dorëzim** nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës ____________, Datë ____/____/2023
**VII.Për t/u trajtuar** nga Specialisti i Sektorit përkatës ____________, Datë ____/____/2023
Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: ________________________________

**Firmë**____________

**VIII. Marrë në dorëzim** nga Specialisti i Sektorit përkatës ____________, Datë ____/____/2023

**Firmë**____________

**IX. Dorëzim i Eprorit porositës,** Datë ____/____/2023
**X.** Shënim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

16339 prot.

Lezhë, më 27 Tetor 2023

**Lënda:** Propozime për ndryshime në Projekt-vendimin "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskaale,strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve".

**Drejtuar:** Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë

Komisionit të Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik

**Baza ligjore:** Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me VKB Nr.54 datë 28.4.2020, e ndryshuar.

Z.Kryetar i Këshillit të Bashkisë!

Në lidhje me Projekt-Vendimin "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve", të propozuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, duke ndjekur me vëmendje ankesat dhe kërkesat e qytetarëve, paraqes propozimet për ndryshime sa vijon:

1- Përjashtimin nga pagesa e të gjitha taksave e tarifave vendore për bizneset që drejtohen nga të rinjtë e moshës 18-35 vjeç, në periudhën 2024-2027.

2- Përjashtimin nga taksat e tarifat vendore të nënave kryefamiljare, nënave vajza dhe nënave që ndjekin studimet e larta.

3- Propozojmë unifikimin e taksës se tabelës për të gjitha bizneset. Niveli i taksës për tabelën e thjeshtë të aplikohet edhe për tabelat me ndriçim dhe elektronike, duke vendosur disa standarte të përshtatshme për anën vizuale.

4- Krahasuar me Paketën fiskale në fuqi për vitin 2023, në projekt-vendimin për vitin 2024 Kryetari i Bashkisë ka propozuar rritjen e taksës mbi truallin, sipas qëllimeve të përdorimit, konkretisht: për qëllime banimi nga individët, nga 0.39 lekë/m2/vit në 0.56 m2/vit; për qëllime biznesi, nga 14 lekë/m2/vit në 20 lekë/m2/vit. Për këtë arsye, propozoj lënien e taksës së truallit në nivelet aktuale sipas parashikimeve të Paketës Fiskale në fuqi për vitin 2023.

5- Sa i përket taksës së fjetjes në hotel, propozojmë uljen në masën 30% edhe për hotelet me 4 e 5 yje, sikurse është propozuar për hotelet me më pak se 4 yje.

6- Propozojmë shfuqizimin e taksës së përkohshme të bizneseve për dekorin dhe zëvendësimin me taksën e përkohshme në masën 2000 lekë për ndërtimin e menaxhimin e qendrave sociale për moshen e tretë.
Hotelet më 4 e 5 yje, si dhe hotelet me nën 4 yje, në zonën bregdetare të Shëngjinit e Tales, të paguajnë taksë të përkohshme respektivisht në masën 15 000 dhe 10 000 lekë në vit për ndërtimin e menaxhimin e qendrave të moshës së tretë në të gjitha njësitë administrative.
Taksa e përkohshme për ndërtimin dhe menaxhimin e qendrave të moshës së tretë të miratohet për 4 vitet e ardhshme.

7- Sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë, propozojmë lënien në fuqi të kategorizimit të ndërtimeve për qëllime banimi apo njesi tregtare, sipas zonave: Shëngjin e Shënkoll, Lezhë, Njësitë e tjera administrative sipas parashikimeve të paketës fiskale në fuqi, e miratuar për vitin 2023. Gjithashtu, propozojmë zbritjen e kësaj takse në masën 30 % krahasuar me parashikimet në Paketën fiskale të vitit 2023. Për ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit, kjo taksë të jetë e unifikuar në 4%.

8- Sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat për qëllime banimi në zonat malore, Kryetari i Bashkisë ka propozuar rritje të kësaj takse nga 1.5 % në 2% . Duke konsideruar domosdoshmërinë e promovimit të turizmit malor, propozojmë që kjo taksë jo vetëm të mos rritet por të jetë zero për dy vitet në vijim.

9- Në Projekt-vendimin e propozuar, Kryetari i Bashkisë ka propozuar rritjen e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike nga biznesi: konkretisht në masën 70% për bizneset e zonës A (Lezhë e Shëngjin) dhe në masën 150 % për biznese të zonës B (Kolsh, Zejmen, Shënkoll). Kundërshtojmë këtë propozim si dhe propozojmë lënien e taskës së shfrytëzimit të hapësirës publike në të njejtat nivele që parashikohen në paketën fiskale në fuqi për vitin 2023.

10- Propozojmë zbritjen në 30% të taksës për tokën bujqësore, përsa kohë infrastruktura vaditje-kullim nuk është funksionale në çdo zonë.

11- Sa i përket tarifës për parkimit, propozojmë që me Vendim të Këshillit të Bashkisë të ndalohet përdorimi si hapësirë parkimi i Sheshit "Gjergj Kastrioti", si zonë arkeologjike me rëndësi të veçantë. Në vijim, propozojmë shfrytëzimin për qëllime parkimi të katit nëntokë të pallatit në lagjen Beslidhja, ndërtuar pas tërmetit të nëntorit 2019, i njohur si pallati i rindërtimit. Kjo hapësirë afërsisht 2000 m2 është e mjaftueshme për të hequr përfundimisht Sheshin "Gjergj Kastrioti" nga lista e vendeve të parkimit në qytet.

Sa më lart, kërkoj nga ana Juaj dërgimin e këtyre propozimeve për konsultim e analizë specialistëve të fushës si dhe Ju bëjmë me dije se nga ana e Bashkisë Lezhë nuk na është vënë në dispozicion informacion zyrtar i kërkuar me shkresë zyrtare.

Ju faleminderit !

Kryetar i grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike

Alfrida MARKU

# TAKSA E PASURISË :

| | ISHTE | U BË NE 2019 | SOT |
|---|---|---|---|
| NDERTESË 100m2 | 3000 lekë | 2400 lekë | 3000 lekë |
| TRUALL 100m2 | 56 lekë | 39 lekë | 56 lekë |

# TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE : (FAMILJARËT)

| | ISHTE | U BË NË 2019 | 2021-2024 |
|---|---|---|---|
| TARIFA SHERBIMESH ZONA A | 3000 lekë | 2400 lekë | 3000 lekë |
| TARIFA SHERBIMESH ZONA B | 1800 lekë | 1200 lekë | 1500 lekë |
| TARIFA SHERBIMESH ZONA C | 1800 lekë | 1200 lekë | 1200 lekë |

| | ISHTE | U BË NË 2019 | 2021-2024 |
|---|---|---|---|
| ND+TRUALL+TARIFE SHERB ZONA A | 5856 lekë | 4439 lekë | 5056 lekë |
| ND+TRUALL+TARIFE SHERB ZONA B | 4656 lekë | 3239 lekë | 3556 lekë |
| ND+TRUALL+TARIFE SHERB ZONA C | 4656 lekë | 3239 lekë | 3256 lekë |

# TAKSA E PASURISE DHE TARIFAT VENDORE PER FAMILJE 100m2 NDERTESE+100m2

| | | ISHTE 2019 | U BE 2019 | 2020-2024 | DIFF |
|---|---|---|---|---|---|
| ZONA | A | 5,856 lek | 4,439 lek | 5,056 lek | -14 % |
| ZONA | B | 4,656 lek | 3,239 lek | 3,556 lek | -24 % |
| ZONA | C | 4,656 lek | 3,239 lek | 3,256 lek | -31 % |



# Taksa e nderteses per Familjaret

| Kategoria | Vlera m2 sipas ligjit | Paketa Fiskale 2024 |
|---|---|---|
| Familjare | 28 leke | 20 leke |

# Taksa e Truallit Familjare dhe Biznes

| Nr | Kategorizimi sipas qëllimit të përdorimit | Njësia | Niveli takses 2019-2023 | Niveli i taksës 2024 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Për qëllime banimi nga individët | Lekë /m²/ Vit | 0.39 | 0.56 |
| 2 | Për qëliime biznesi | | 14 | 20 |

# Taksa e nderteses per biznes

| Kategoria | Vlera m2 sipas ligjit | Paketa Fiskale 2024 |
|---|---|---|
| Biznes a) | 168 leke | 119 leke |
| Biznes b) | 78.4 leke | 55 leke |
| Biznes c) | 33.6 leke | 23.5 leke |
| Biznes ç) | 56 leke | 39.2 leke |
| Biznes d) | 33.6 leke | 23.5 leke |

# Taksa e Tokes Bujqesore

| Nr | Kategoritë e tokës | Njësia | Niveli i taksës sipas Ligjit | Niveli I takses 2019-2024 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I | Lekë / Ha / Vit | 5600 | 3920 |
| 2 | II | | 4900 | 3430 |
| 3 | III | | 4200 | 2940 |
| 4 | IV | | 3600 | 2520 |
| 5 | V | | 3000 | 2100 |
| 6 | VI | | 2400 | 1680 |
| 7 | VII-X | | 1800 | 1260 |

# TAKSA E TABELËS :

| Nr | Kategorizimi i Tabelave | Njësia | Niveli i taksës | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zona A (2019) | Zona A(SOT) | Zona B & C | Zona B & C (SOT) |
| 1 | Tabela për qëllime identifikimi te veprimtarise se subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) | | | | | |
| a | Deri ne 2 $m^2$ | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| b | Mbi 2 $m^2$ deri ne 10 $m^2$ | | | | | |
| | E thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/$m^2$/vit | 10.000 | 2.000 | 10.000 | 1.000 |
| | Me ndriçim të thjeshtë | | 15.000 | 5.500 | 15.000 | 3.000 |
| | Elektronike | | 20.000 | 7.500 | 20.000 | 5.000 |
| c | Mbi 10 $m^2$ deri ne 20 $m^2$ | | | | | |
| | E thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/$m^2$/vit | 8.500 | 1.800 | 8.500 | 900 |
| | Me ndriçim të thjeshtë | | 12.750 | 5.000 | 12.750 | 2.700 |
| | Elektronike | | 17.000 | 6.750 | 17.000 | 4.500 |
| ç | Mbi 20 $m^2$ deri ne 40 $m^2$ | | | | | |
| | E thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/$m^2$/vit | 5.500 | 1.620 | 5.500 | 810 |
| | Me ndriçim të thjeshtë | | 8.250 | 4.500 | 8.250 | 2.450 |
| | Elektronike | | 11.000 | 6.100 | 11.000 | 4.000 |
| d | Mbi 40 $m^2$ | | | | | |
| | E thjeshtë (pa ndriçim) | Lekë/$m^2$/vit | 4.000 | 1.460 | 4.000 | 730 |
| | Me ndriçim të thjeshtë | | 6.000 | 4.000 | 6.000 | 2.200 |
| | Elektronike | | 8.000 | 5.500 | 8.000 | 3.600 |
| 2 | Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim | | | | | |
| | Tabela identifikuese | Lekë/$m^2$/vit | 120 | 42 | 120 | 21 |
| 3 | Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, deri në tavanin maksimal 35 $m^2$. | | | | | |
| a | E thjeshtë (me/pa ndriçim) | Lekë /$m^2$/vit | 22.500 | 5.000 | 22.500 | 3.000 |
| b | Elektronike | | 45.000 | 18.000 | 31.500 | 18000 |
| 4 | Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj | | | | | |
| | Të të gjitha llojeve dhe përmasave | Lekë /$m^2$/ditë | 1.000 | 350 | 1.000 | 170 |

- Përjashtohen nga Tarifat e Sherbimit Publik (Ndricim, Gjelbrim, Pastrim dhe Dekor) të gjithë subjektet e Tranportit Urban në rastin kur ata sherbejnë kategorinë e Pensionistëve pa biletë transporti.

- Të gjithë Bar – Kafet që investojnë në ambjente për kend lojrash për fëmijë, përjashtohen nga pagesat e Tarifave të Sherbimit Publik (Ndricim, Gjelbrim, Pastrim dhe Dekor).